



THIRRJE PUBLIKE nr. 0 1 / 2 0 1 5

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në Peshkatari dhe Akuakulturë për vitin 2015

I. LËNDA E THIRRJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj thirrje është ndarja e përkrahjes financiare për nënpikat nga masat në vijim:

Masa 1	Përkrahja financiare për peshkatari	Mjetet	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 1.3	Pika peshkimi – ndërtim i të pikave të reja, rikonstruim dhe adaptim të atyre ekzistuese për peshkim, kompensim për shfrytëzimin e pika ekzistuese	1.500.000,00 denarë	
Nënpika 1.4	Përkrahje financiare për rehabilitim të ujërave për peshkim me rindërtim, mbindërtim dhe pajisje të kapaciteteve ekzistuese/vendeve për kultivimin e peshkut për prodhim të materialit reproduktiv dhe të peshkimit	2.100.000,00 denarë	
Nënpika 1.5	Ndërtim dhe rikonstruim të mandrave për gjah tradicional të peshqve në Liqenin e Dojranit	1.200.000,00 denarë	
Nënpika 1.7	Mbrojtje shtesë e peshqve në ujërat për peshkim	5.000.000,00 denarë	Deri më 60.000 denarë për mbrojtje të rivierave për peshkim dhe zoneve rekreative Deri më 300.000 denarë për mbrojtje të zonave për peshkim Deri më 1.500.000 denarë për mbrojtje të hapësirave për peshkim

Masa 2	Përkrahje financiare në akuakulturë	Mjetet	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.1	Përkrahje financiare për investime në akuakulturë	19.000.000,00 denarë	3.500.000,00 denarë shfrytëzues individual
	- Ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë		
	- Zgjerim, rikonstruim, adoptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë		
	- Ndërtim të kapaciteteve të reja për përpunimin e peshqve		
	- Furnizim i pajisjes për përpunim, deponim dhe paketim të peshqve		

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për nënpikat:

Subjekti	Nënpika
Njësi të vetëqeverisjes lokale për ndërtim të pikave të reja, rikonstruim dhe adoptim të pikave ekzistuese për peshkim, ndërsa shfrytëzues të mjeteve për kompensim të shërbimit për shfrytëzim të pikave ekzistuese janë koncesionerët e peshqve.	1.3
Reproqendra të regjistruara për prodhim të materialit reproduktiv dhe për shumim të peshqve;	1.4
Njësia e vetëqeverisjes lokale dhe koncesioneri i peshqve për peshkim ekonomik të Liqenit të Dojranit.	1.5
Koncesionerët e peshqve nga ujërat për peshkim. Një koncesionet mund të shfrytëzojë mjete vetëm për një periudhë të caktuar dhe të ndalesës së peshkimit	1.7
<b>Shfrytëzues të mjeteve dedikuara për ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë janë:</b> Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe të cilët posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilin planifikojnë të ndërtojnë kapacitet për akuakulturë; ose posedojnë leje për shfrytëzim të ujit për vendosjen e kafazeve në zonat e parapara për akuakulturë	2.1
<b>Shfrytëzues të mjeteve të dedikuara për zgjerim, rikonstruksion, adoptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë janë:</b> Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë, dhe të jenë të regjistruar në regjistrin të kultivuesve të peshqve që është në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave;	2.1

<b>Shfrytëzuesit e mjeteve të dedikuara për ndërtim të kapaciteteve të reja për përpunimin e peshqve janë:</b> Subjektet të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe të cilat posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilin planifikojnë të ndërtojnë kapacitete përpunuese;	2.1
<b>Shfrytëzues për mjete dedikuara për furnizim të pajisjeve për punim, përpunim, deponim dhe paketim të peshqve janë</b> Subjektet të cilat janë në rangun e ndërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të cilat posedojnë ose shfrytëzojnë objekt të dedikuara për përpunimin e peshqve.	2.1

III. LARTËSIA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, harxhime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe harxhime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2015 (Gazeta Zyrtare nr. 194/2014).

Për Masën 1, përkrahja financiare paguhet me princip të bashkëfinancimit të investimeve përfundimtare dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 100% nga vlera e harxhimeve të lejuara të pranueshme për investime ose nga kompensimi i shërbimit.

Për Masën 2, përkrahja financiare paguhet me princip të bashkëfinancimit të investimeve përfundimtare dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumë prej 50% nga vlera e harxhimeve të lejuara të pranueshme për investime. Shkalla e bashkëfinancimit rritet deri në 55%, 60% dhe 65% në rastet kur:

- 55% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga dërgues i ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore;

- 60% nga vlera e investimit të lejuar, për investime në ekonomi bujqësore e cila gjendet në vende rurale kodrinoro-malore;

- 65% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga dërgues i ekonomisë bujqësore prej moshës 18 vjeçare deri në moshën 40 vjeçare në ditën e dorëzimit të investimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore që gjendet në vendet rurale kodrinoro-malore.

Përkrahja e ndarë financiare është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET

Kërkesa për secilën nënpikë dorëzohet në origjinal.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkuarit e mjeteve janë të vërtetuara në Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2015 (Gazeta Zyrtare nr. 194/2014).

**Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa se sa ka mjete të disponueshme në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2015, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuarësve që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.**

Kërkuarit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, me përjashtim të nënpikës 1.7

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" (Formulari PRA-A1) dhe "Kërkesa për pagesë" (për nënpikën 1.7) me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk) ose [www.pa.gov.mk](http://www.pa.gov.mk)

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjencinë në adresën çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në 16:30:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20 (ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup**

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2015 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2015 dhe shënimin e shifrës së masës/nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për aritjen e vonuar ose të pakompletuar deri në sportel apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 14.05.2015 година.**

**Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.**

Informatat më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejm të projekteve dhe Sektori për lejimin e pagesës.

Telefoni: 02/3097-460, çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 16.30.

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL